

UNIVERSITETI "NËNË TEREZA" - SHKUP  
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ - СКОПЈЕ  
UNIVERSITY "MOTHER TERESA" - SKOPJE

# PROGRAMI PËR PUNËN DHE ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT NËNË TEREZË-UNT 2022-2025

*Prof. Dr. Izet Zegiri,*

*Anëtarë korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, RMC*



SHKUP, 2022

## Përmbajtja:

|   |    |
|---|----|
| <b>HYRJE</b> .....  | 3  |
| <b>MOTIVIMI</b> .....   | 5  |
| <b>1. VIZIONI, QËLLIMET E PËRGJITHËSHME TË UDHËHEQJES SË UNT</b> .....                                    | 6  |
| <b>2. STRUKTURAT, PROCESET DHE PROCEDURA PËR T’I ARRITUR QËLLIMET NË UNT</b> .....                        | 8  |
| <b>A) OBJEKTIVAT NË FUSHËN E ORGANIZIMIT DHE MENAXHIMIT TË UNT</b> .....                                  | 9  |
| <b>B) OBJEKTIVAT NË VEPRIMTARINË AKADEMIKE, PROGRAMET E STUDIMIT &amp; KOMPETENCAT PROFESIONALE</b> ..... | 13 |
| <b>C) OBJEKTIVAT NË LËMINË E MËSIMDHËNIES, MËSIMNXËNIES DHE HULUMTIMIT</b> .....                          | 15 |
| <i>Infrastruktura mësimore</i> .....  | 15 |
| <i>Integrimi i hulumtimit dhe ndërmarrësisë në UNT</i> .....  | 16 |
| <i>Përgatitje, aplikim dhe zhvillim projektesh</i> .....  | 16 |
| <b>D) OBJEKTIVAT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË CILËSISË</b> .....   | 17 |
| <i>Përmisim të kushteve të studentëve</i> .....   | 18 |
| <i>Organizimi bibliotekës (online dhe fizike) për shfrytëzimin e literaturës</i> .....                    | 20 |
| <i>Alumni Netuork</i> .....   | 21 |
| <b>E) TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I STAFIT TË UNT</b> .....  | 22 |
| <b>F) OBJEKTIVAT NË FUSHËN E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT</b> .....                                      | 23 |
| <i>Objektivat në komunikim dhe bashkëpunim</i> .....  | 23 |
| <b>G) OBJEKTIVAT NË BASHKËPUNIM MES UNIVERSITETEVE DHE KOMUNITETIT TË BIZNESIT</b>                        | 24 |
| <b>H) FINANCIMI I UNT</b> .....   | 25 |
| <b>I) OBJEKTIVAT PËR PROMOVIMIN E UNT</b> .....   | 31 |

## HYRJJE

**U**niversiteti „Nënë Tereza” (UNT) u themelua me Ligj me datë 24.12.2015. Kjo padyshim shënoi një faqe të re të zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe, e në veçanti edhe një kontribut plotësues për zhvillimin e gjithmbarshëm socio-ekonomik dhe kulturor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Hapja e një institucioni të arsimit të lartë në gjuhën shqipe në kryeqendrën e vendit, padyshim paraqet një mundësi plotësuese për fuqizimin e studimit në disa fusha deficitare të vërejtura nga aktiviteti i deritanishëm i universiteteve ekzistuese në gjuhën shqipe dhe jo vetëm kjo, njëherit, konsolidimi i një institucioni të tillë, paraqet edhe sfidë unike për rrethanat tona. Nisur nga kjo, pas realizimit të procedurave përkatëse të parapara me ligjin e arsimit të lartë (LAL), që zgjati gati gjithë vitin 2016, me datë 27 Tetor 2016 filloi me punë UNT me gjeneratën e parë me 240 studentë të disperzuar në 11 programe studimore të akredituara. Viti vijues 2016/2017 filloi me kushte më të mira duke regjistruar mbi 500 studentë në 19 programe studimore të akredituara nga 21 të tilla. Meqë themeluesi ende nuk kishte votuar Statutin e UNT, u vonuan të gjitha procedurat ligjore për konsolidimin e plotë të institucionit gjë që u bë e mundur me datë 4 Prill kur Kuvendi i Maqedonisë e aprovoi Statutin e UNT-së duke i hapur rrugë procedurave përkatëse ligjore për konsolidimin e universitetit.

*Institucion Arsimit të Lartë UNT, i përbërë nga pesë fakultete dhe 36 drejtime dhe me 2200 student, të një lloji dhe rëndësie të veçantë, të pa zëvendësueshëm dhe me një perspektivë mjaft të qartë. Në kuadër të Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup do të funksionojnë pesë (5) fakultete, edhe atë: Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (me programet studimore: Arkitekturë dhe Dizajn, Ndërtimtari, Gjeodezi dhe Gjeo-Informatikë), Fakulteti i Shkencave të Informatikës (me programet studimore: Informatikë dhe Informatikë, në gjuhën angleze), Fakulteti i Shkencave Teknike (me programet studimore: Sistemet Elektro-Energjetike, Inxhinieri Makinerie dhe Menaxhment, Inxhinieri e Komunikacionit dhe Transportit, Inxhinieri Ekonomike, Mekatronikë), Fakulteti i Shkencave Teknologjike (me programet studimore: Inxhinieri e Materialeve dhe Nano-Teknologjive, Teknologjia Ushqimore) dhe Fakulteti i Shkencave Sociale (me programet studimore: Politika Sociale dhe Puna Sociale, Studime Evropiane).*

*Ky universitet do të jetë një mjedis i promovimit të vlerave të mirëfillta arsimore e shkencore, si një qendër që prodhon kuadro që do e çojnë shoqërinë dhe kombin përpara. Universiteti do të funksionojë konform standardeve më të larta ndërkombëtare, duke sjellë cilësi dhe studentë të përgatitur që t'i bëjnë ballë ekonomisë së tregut dhe globalizimit shoqëror.*

*Administrata e përkohshme e universitetit edhe në kushte jo të favorshme ka realizuar të gjitha aktivitetet e duhura për organizimin e studimeve për dy gjeneratat në vijim, edhe atë:*

- *Mësimi pa pengesa këto dy vite dhe në vijimësi po mbahet në dy objekte; në ndërtesën e Lidhjes së Sindikatave të RMV (2000 m<sup>2</sup>) dhe në katin e dytë të Shkollës fillore „Kongresi i Manastirit”, (rreth 600 m<sup>2</sup>). Njëherit disa ushtrime laboratorike janë realizuar në institucione adekuate, me të cilët kemi marrëveshje bashkëpunimi (IPSH). Mësimi, kolokuiumet dhe provimet janë mbajtur në përputhje të plotë me kalendarin akademik të aprovuar nga organet e UNT-së. ).<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> [www.unt.edu.mk](http://www.unt.edu.mk) Programii i punës së Universitetit „ NËNË TEREZË „për periudhën 2018-2022 nga prof. dr.Aziz Pollozhani

## MOTIVIMI

**U**në Izet Zeqiri anëtarë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut, profesor ordinar i zgjedhur ne UEJL, i përgatitur dhe i kompletuar me ambicie për kultivimin edhe të më tepër përvojave akademike dhe menaxheriale si pjesëmarrës në mënyrë aktive në jetën universitare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në përpjekje për ta verifikuar performancën menaxheriale dhe profilizimin dhe zhvillimin universitar dhe akademik, jam i interesuar për pozitën e rektorit në Universitetit Nënë Terezë. Duke u bazuar në aftësitë e mia menaxheriale dhe eksperiencën në pozitat menaxheriale në institucione arsimore se: Dekan i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tetovës, Dekan i Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë në UEJL, Prorektor për mësim i Universitetit Dardania në Prishtinë, zëvendës kryetar i Bordit të Akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në vend, sekretar gjeneral i Akademisë Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut dhe shumë pozita tjera menaxheriale në fushën e ekonomisë dhe biznesit; mendoj se mundet të jap kontributin e duhur në menaxhimin dhe zhvillimin e UNT në mandatin e rektorit.

Kompleksiteti dhe shumë dimensionaliteti i ndryshimeve ekonomike dhe shoqërore në Maqedoninë e Veriut por edhe me gjërë, drejtëpërsëdrejti reflektohen edhe në menaxhimin, strukturimin, funksionimin dhe organizimin e institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut. Në këtë kontekst, jo vetëm procesi i mesimdhënie dhe hulumtimit është një proces proaktiv për të siguruar një kompatibilitet afatgjatë në jetën universitare dhe në konkurrencën agresive universitare, por edhe pjesmarrja në procesin i menaxhimit të njësisve të institucioneve të arsimit të lartë është sfidë me interes dhe krijon mundësi për zhvillim në garën e konkurrencës në Arsimin e lartë.

I motivuar nga kjo unë si kandidat potencial për rektor i Universitetit Nënë Terezë, me gjuhë proaktive do ta bashkoj autoritetin profesional dhe kompetencën për të patur rezultate të dëshiruara në menaxhimin e UNT. I vetëdijshëm për mjedisin e punës mësimore-shkencore të UNT, duke bërë gjykime të ndërgjegjshme lidhur me masat më të efektshme që çojn drejt rezultateve të larta dhe ngritjes së pozitës aktuale të UNT në rafshin lokal dhe regional. Këtë punë nuk do ta bëjë nëpërmjet të objektivave ambicioze individuale por duke nxitur bashkëpunimin e gjërë dhe angazhimin e përbashkët e të gjitha strukturave të universitetit, stafit mësimdhënës, administratës dhe studentëve etj.

## 1. VIZIONI, QËLLIMET E PËRGJITHËSHME TË UDHËHEQJES SË UNT

**N**isur nga vizioni, UNT që nga fillimi ka synuar shndërrimin e universitetit në qendër ekselence rajonale, qendër të dijes, krijuese e profesionistëve kompetent, të gatshëm për ballafaqim dinjitoz me sfidat e së ardhmes. Misioni i UNT-së dikton që si institucion ai duhet ti shërbejë krijimit të gjeneratave me arsim cilësor, aftësi hulumtuese dhe inovative, me kompetenca akademike dhe profesionale në fushat e shkencave informatike, tekniko-teknologjike dhe ato sociale, të kërkuara nga tregu i punës, kontribues në kohezionin social në rrjedhat integruese dhe globalizuese.

Vizioni dhe misioni i UNT të themeluar në Shkup është përmbushja e nevojave të shoqërisë për plotësimin e boshllëkut në fushën e arsimit të lartë. Në këtë kontekst edhe misioni i UNT si institucion i arsimit të lartë është të ndihmojë vendin dhe më gjërë regjionin, me përgatitjen dhe shkollimin e kuadrove të reja në fushën e shkencave teknike dhe shkencave shoqërore të cilët do ti përgjigjen tregut të punës, zhvillimit ekonomik dhe integritimeve ndërkombëtare.

Në përmbushje të këtij vizioni, drejtimet ose synimet kryesore të aktiviteteve edukative, mësimore dhe shkencore, të UNT janë:

- UNT të veprojë si qendër për ngritjen dhe profesionalizimin e lartë bashkëkohor universitar dhe pasuniversitar (master dhe doktoraturë) të dijes dhe shkencës për Maqedoninë e Veriut dhe më gjërë.
- Të jëtë i përkushtuar dhe i hapur për të gjithë studentët mbi bazën e barazisë dhe të meritës, pavarësisht nga prejardhja e tyre ideologjike, politike, kulturore , shoqërore dhe racore;
- Të edukojë dhe të përgatisë studentë në fushën shkencave teknike dhe sociale me qëllim të bëhen “Liderë të mendimit dhe të veprimit”, specialistë të profileve përkatëse, duke u dhënë prioritet arritjeve të standardeve evropiane të arsimit të lartë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.;
- Të zhvillojë mendimin kritik dhe krijues me qëllim që studentët të kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve dhe shoqërisë mbi bazën e njohurive dhe përgjegjësiwe profesionale dhe etike;
- Dinamika e zhvillimit ekonomik, ritmet e rritjes së numrit dhe madhësisë së bizneseve si dhe rritja e kompleksitetit të tyre do të jëtë shtysa kryesore në hartimin e profileve të diplomave dhe programeve të moduleve përkatëse.
- Të synojë të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta bashkëkohore në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore, të jap ide dhe sygjerime për zhvillimin

shoqëror-ekonomik, të bëjë përgatitjen e kuadrove në fusha të ndryshme profesionale duke u përshtatur standardeve evropiane të arsimit;

- Të forcohet struktura e ofertes akademike e UNT me planprograme të kompletuara sipas standardeve evropiane në master dhe studime të doktoraturës dhe sipas kërkesave të tregut të punës.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se në kushtet e konkurrencës jo lojale në arsimin e lartë, strategjitë e ndryshimit në UNT duhet të jenë në hap me përcaktimin e strategjisë zhvillimore të Universitetit NËNË TEREZË, në fushën e integritit, dimensionimit dhe kooperimit të universitetit dhe në hap me proceset shkencore-teknike dhe teknologjike si korniza për planifikimin e zhvillimit të Universitetit Nënë Terezë. Kompleksiteti dhe shumë dimensionaliteti i ndryshimeve ekonomike shoqërore në Maqedoninë e Veriut por edhe më gjërë drejtëpërsëdrejti reflektohen edhe në koncipimin, strukturimin, funksionimin dhe organizimin e sistemit të arsimit të lartë, në këtë kontekstë ne duhet të jemi shumë proaktiv për të siguruar në kompatibilitet afatgjatë të UNT. Rethanat e reja në tregun e punës imponojnë edhe inovimin e programeve të reja të cilat do të mundësojnë rritjen e sasisë dhe cilësisë së diturive dhe fondin e të dhënave shkencore ekonomike të studentët.

## 2. STRUKTURAT, PROCESET DHE PROCEDURA PËR T'I ARRITUR QËLLIMET NË UNT

**K**ur mendoj në realizimin e qëllimeve në UNT, që ky institucion i lartë arsimor ti plotësoj nevojat, qëllimet dhe detyrat e veta arsimore shkencore dhe të ngritet si një qendër me afirmim regional edhe më gjërë, para së gjithash mendoj në disa elemente vijuese që i kërkon një institucion arsimor-shkencorë mirë i organizuar:

- 🌐 Sinergjia dhe puna ekipore TEAM ( together everyone achieves more ),
- 🌐 Respekti i ndërsjellë,
- 🌐 Ndihma njëri tjetrit dhe plotësimi,
- 🌐 Diskutimi për problemet,
- 🌐 Dallueshmëria, motivimi,
- 🌐 Mundësi të barabarta,
- 🌐 Afirmim cilësor i mësimdhënies dhe mësimnxënies,
- 🌐 Aftësi për të reaguar shpejtë dhe në harmoni me dimensionin kohor,
- 🌐 Besim, kredibilitet,
- 🌐 Hapje ndaj inovacioneve,
- 🌐 Gadishmëri për të pranuar reziqe të kuptueshme etj.

Programin tim për Rektor potencial të UNTdo ta fokusoj në këto shtylla kryesore të angazhimit tim: Pjesën organizative, pjesën programore, komunikimin ndër-institucional, politikat dhe procedurat zyrtare për vlerësimin e cilësisë e të standardeve të programeve dhe trajnimi dhe zhvillimi i stafit.



## A) OBJEKTIVAT NË FUSHË E ORGANIZIMIT DHE MENAXHIMIT TË UNIVERSITETIT NËNË TEREZË

**P**lanifikimi strategjik është një mjet menaxhimi për të parë të ardhmen, mundësitë, apo sfidat për të fituar pozicionin konkurrues. Në kohën e ndryshimeve turbulente të rrethinës, nuk është lehtë të ndiqen ndryshimet dhe të identifikohen pyetjet e rëndësishme strategjike që janë me rëndësi për suksesin e universitetit dhe fakulteteve dhe për marrjen e vendimeve strategjike. Në ndryshimet e rrethinës shpesh reagohej ex-post. Prandaj, është e rëndësishme për UNT të reagojë në mënyrë të planifikuar në bazë të situatës së diagnostikuar dhe vlerësimit të mënyrave alternative të reagimit në situatë të caktuar. Planifikimi strategjik për tre vite mundëson që UNT të përballet me të ashtuquajtura shoqe të ardhmërisë të cilat vijnë në situata kur e ardhmja për organizatën vjen më shpejtë se sa është paramenduar dhe i gjen të pa përgatitur si edhe kur shpejtësia e reagimit është e vonuar. *Plani strategjik i UNT na mundëson:*

**E para:** Plani strategjik do të na mundësoj marrjen e vendimeve të tashme në dritën e ardhmërisë së tyre, me anë të të cilave, ajo identifikon shanset dhe kërcënimet, gjegjësisht faktorët pozitiv dhe negativ jashtë UNT.

**E dyta:** Planifikimi strategjik në UNT do të na mundëson, krijimin e vizionit, misionit, qëllimeve dhe objektivave nga të cilat definohen politikat, alternativat strategjike për realizimin e tyre dhe zhvillimi i planeve të detajuara për realizimin e tyre.

Përmes planifikimit strategjik UNT, duhet tu përgjigjet pyetjeve fundamentale edhe atë:

- 🌐 Ku jemi ne tani? (**Vlerësimi**)
- 🌐 Ku ne duam të jemi? (**Shprazëtira / E ardhmja**)
- 🌐 Si do ta mbyllim shprazëtirën (**Strategic Plan**)
- 🌐 Si do ta monitorojmë progresin (**Scorecard – fletënotim i balancuar**)

Modeli i planifikimit strategjike që do ta implementojmë në UNT është paraqitur në ilustrimin në vijim dhe përfshin elementet: *Ku ne jemi? Ku ne duhet të shkojmë? Si ne do të arrijmë atje dhe si do të veprojmë ne?*

**Fig.1** Modeli i planifikimit strategjik i Universiteti Nënë Tereza<sup>2</sup>



Do të vazhdojë praktika e mirë e planifikimit strategjik në UNT, e cila do të përforcojë edhe më tej UNT të vendoset një “menaxhment i bazuar në performancë”. Prandaj, që të sigurojmë një perspektivë afatgjate dhe pozicionim më të fortë në treg, duhet të jetësohet një sistem i besueshëm i bazuar në të arriturat – performancën. Për ta arritur këtë, do të nevojitet që të ndërtohet një paradigmë e re, e cila do të integronte funksionet e menaxhmentit me aktivitetin akademik. Kjo, do të fillojë me dhënien e shembullit të mirë nga Rektori i ri dhe ekipi i tij menaxhues, si dhe nga liderët e fakulteteve dhe të njësive të tjera akademike. Në këtë mënyrë, i gjithë komuniteti, përfshirë këtu edhe administratën, do të shëndërrohen në ndërtues të drejtpërdrejtë të rolit të ri të UNT vendoset një cikël një vjeçar i vlerësimit të performancës për të gjithë dhe njëkohësisht po kjo do të jetë edhe baza e vetme për të vlerësuar punën dhe progresin në universitet.

Në menaxhimin e UNT si rektor do të jap rëndësi të veçantë rolit ndërpersonal (ndërnjerëzor). Ky rol ka të bëjë me relacionet me të tjerët në UNT dhe jashtë saj posaqërisht si rektor do të mundohem të jem figurë qendrore, lider dhe ndërlidhës midis njerëzve të niveleve të ndryshme të UNT dhe ndërlidhës midis UNT dhe pretendentëve të universitetit. Si rektor në menaxhimin e UNT rëndësi do i jap rolit informativ, që është i lidhur me pranimin, ruajtjen dhe transmetimin e informacionit si vrojtues, e monitorues i cili në mënyrë

<sup>2</sup> I.Zeqiri Menaxhimi strategjik, Krijimi i avantazhit konkurrues, Shkup 2016

të vazhdueshme kërkon dhe merr informacione, skanon materiale të ndryshme në formë të raporteve periodike që mund t'i përdorë, udhëheq me kontaktet personale në UNT, me qëllim që të mbledh sa më shumë informacione se si punon universiteti dhe çka që mund të përmirësohet. Si rektor rëndësi të veçant kanë aktivitetet vendosëse. Do të paraqitem në shumë situata si sipërmarrës. Në këtë rol rektori nis projekte përparuese, identifikon ide të reja, delegon idetë e të tjerëve etj. Si rektor do jem edhe trajtues i konflikteve. Në këtë rol do të merrem me zgjidhjen e konflikteve të ndryshme ë, që mund të ekzistojnë midis punonjësve të fakulteteve të ndryshëm, midis niveleve të ndryshme. Menaxheri merret edhe me zgjidhjen e konflikteve midis organizatës dhe rrethinës së jashtme (pretendentëve). Në menaxhimin tim do të paraqitem edhe shpërndarës i drejt burimeve. Në këtë rol rektori bën shpërndarjen e drejt të burimeve njerëzore, materiale midis departamenteve, vendos kush do t'i shfrytëzojë resurset, buxhetet etj.

Si rektor me gjuhë proaktive do ta bashkoj autoritetin profesional dhe kompetencën për të patur rezultate të dëshiruara në udhëheqjen e UNT edhe ate:

- 🌐 Do të krijoj mjedisin e punës mësimore-shkencore të UNT duke bërë gjykime të ndërgjegjëshme lidhur me masat më të efektëshme, që çojnë drejt rezultateve të larta dhe ngritjes së pozitës aktuale të UNT. Këtë punë nuk do ta bëjë nëpërmjet të objektivave ambicioze individuale por duke nxitur bashkëpunimin e gjërë me udhëheqësin e universitetit me senatin, prorektorët, dekanët dhe me mësimdhënësit dhe stafin administrativ.
- 🌐 Me punën time si rektor, do të jem i impenjuar në përpunimin e një strategjie të zhvillimit dhe oragnizimit më të mirë të UNT duke udhëhequr përpjekjet dhe jo thjesht duke qëndruar mbi të tjerët.
- 🌐 Nuk mendoj riorganizimin dhe ristrukturimin e UNT në dëm të ekipit të tashëm mësimor-shkencor, por me debate parimore në këshillin mësimor-shkencor do ti eliminojm të gjitha problemet që i kemi dhe që do të na paraqiten në të ardhmen.
- 🌐 Do ta shfrytëzoj procesin e verifikimit dhe kontrollit të punës mësimore shkencore në fakultete, se a kryhet çdo gjë në përputhje më rregulloren dhe planin e punës së hartuar, madje duke shfrytëzuar edhe sistemin anketues me studentët.
- 🌐 Do të propozoj vleresim të performancës së mësimdhënësve nëse ka ankesa nga studentët, me qëllim të përcaktojm rezultatet e punës nëpërmjet karahasimit të nivelit faktik të saj, kundrejtë standardeve të vendosura të punës mësimore shkencore në fakultetet.
- 🌐 Nxitje e bashkëpunimit të UNT me institucionet shkencore dhe komunitetin e biznesit, institutet dhe

qendrat e biznesit brenda dhe jashtë vendit.

- Përmirësim i planifikimit të angazhimeve dhe orareve të stafit akademik.
- Përmirësim i organizimit të procesit të menaxhimit të procedurave të magjistrimit të kandidatëve dhe doktorimit të kandidatëve.
- Themelimi i Akademive përkatëse për përkrahje dhe zhvillim të biznesit.
- Përmirësim i proceduarve dhe realizimit të punës praktike/përgatitja e një udhëzimi të ri për punën praktike të studentëve.
- Përmirësim i kompetencave digjitale të stafit dhe të studenteve etj.

## B) OBJEKTIVAT NË VEPRIMTARINË AKADEMIKE PROGRAMET E STUDIMIT & KOMPETENCAT PROFESIONALE

Objektivat fundamentale në qasjen programore do të jenë:

- Harmonizimi, bashkëkohësimi dhe inovimi i programeve dhe përmbajtjeve mësimore të cilat do t'ju mundësonin studentëve përvetësim të fondit të caktuar të diturive në UNT.
- Avansimi i planeve dhe programeve mësimore të cilat do të mundësojnë ngritje permanente të arsimit, afirmimit cilësor të shkencës në përputhje me programet, konceptet arsimore të top fakulteteve si motra në SHBA dhe të shteteve Evropiane.
- Komponim të programeve mësimore që do të afirmojnë orientimin kah studimet- eksperimentale dhe gjurmimet aplikative të cilat do të mundësonin parimet e shkencës së ekonomisë të mësohen si mjete të analizës (të mësuarit e koncepteve të zhvillohen në kontekstin e zbatimit).
- Programet studimore, në të gjitha ciklet, do të rishikohen dhe revidohen, duke u bazuar në trendët aktuale të regjistrimit të studentëve, indikatorëve – nevojave të tregut, kostos së programit, punësueshmërisë së të diplomuarve dhe përkushtimit të stafit akademik;
- Do të përkrahen dhe zhvillohen programe të reja studimore në fushat në të cilat do të ofrohen dëshmi të dokumentuara që burojnë nga analiza të thukta të nevojave të tregut, të pasuara me plane cilësore biznesi dhe për të cilat janë identifikuar resurse të nevojshme;
- Të hartojmë programe të cilat do të mundësonin që puna hulumtuese e kuadrit shkencor të mos mbetet vetëm si çështje individuale por në kuadër të UNT të bëhen hulumtime të organizuara shkencore ekonomike me karakter të interesit kombëtar.
- Identifikimi i nevojave për kuadër mësimor shkencor, profesor me qëllim të freskimit permanent të kuadrit mësimor egzistues të UNT me punëtor shkencor rezultativ.
- Të krijojmë një gardë të re të asistentëve të talentuar dhe hulumtuesish duke u ofruar atyre trajnim të vazhdueshën si në vend dhe në botë.

Është evidente se ekziston një mospërputhje midis të diplomuarve dhe nivelit të punësimit të studentëve. Është e domosdoshme që fakultetet, departamentet dhe të gjithë anëtarët e stafit akademik që të angazhohen seriozisht për të rivlerësuar nivelin e profesionalizmit, fleksibilitetit dhe atraktivitetit të kurrikulave, për të mundësuar programe studimi sa më profesionale për tregun e punës.

Është i rëndësishëm formimi teorik & praktik i studentëve, brenda universitar të UNT. Objektivi ynë themelor do të jetë rritja e cilësisë. Në këtë kuadër, do të punohet dhe do të kërkohet çdo element i mësimit (leksione, seminare, laboratorë, projekte kursi, detyra kursi, provime ndërmjetëse, praktikë mësimore etj.) do të jetë i vlerësueshëm gjatë semestrit duke e vënë theksin në rritjen e peshës së tyre.

Gjithashtu është i rëndësishëm edhe formimi praktik i studentëve jashtë universitetit. Do të kërkohet rishikim rrënjësor i programeve të praktikës profesionale të studentëve. Do të bëhen të gjithë përpjekjet që brenda periudhës së praktikës profesionale, studenti të mund të bëjnë praktikën në ndërmarrje apo institucione. Do të punohet për të zgjidhur problemet e zhvillimit të praktikës profesionale të studentëve në ndërmarrje dhe institucione.

## C) OBJEKTIVAT NË LËMINË E MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES DHE HULUMTIM

**F**okusi i menaxhmentit të UNT do jetë i përqendruar në krijimin e infrastrukturës mësimore me objektiv kryesor ngritja e procesit të mësimdhënies, mësimnxënies dhe realizimi i hulumtimeve-projekteve vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë drejtim do nënvizoja me sa vijon:

- Rifreskim i literaturës së preferuar në suaza të syllabuseve të lëndëve përkatëse.
- Përmirësim i mëtejshëm i mësimdhënies dhe mësimnxënies përmes implementimit të teknikave dhe metodave bashkëkohore në klasë. Nxitje e stafit që në bashkëpunim me studentët të gjenerojnë studime rasti për kompanitë konkrete në mjedisin tonë.
- Nxitje e stafit që sa më gjerësisht të zbatojnë teknikën “classroom flipping”
- Nxitje e stafit akademik të angazhohet në përpilim të teksteve universitare.
- Sigurim i fondit për përkrahje të publikimit të teksteve universitare
- Inicim i ndryshimit të rregulloreve për përkrahjen e botimeve
- Nxitje e participimit të stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare, revista shkencore, përpilim të teksteve universitare, projekte hulumtuese.
- Përgatitja dhe realizimi i projekteve hulumtuese dhe konferencave shkencore.
- Nxitje e stafit akademik të aplikojë për publikim në revista shkencore ndërkombëtare pa pagesë.
- Nxitje e stafit akademik të aplikojë për anëtarësim në borde editoriale të revistave shkencore ndërkombëtare.
- Organizimi i konferencës shkencore të UNT
- Organizim dhe implementim i projekteve hulumtuese në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe institucionet tjera.

### *Infrastruktura mësimore*

Infrastruktura mësimore është shumë me rëndësi. Ndër të tjera, do të vlerësohen me përparësi:

- Pajisja e të gjitha sallave të leksioneve (atje ku nuk ka) me mjete audiovizive, në ndihmë të zhvillimit të mësimin.
- Fokusi i investimeve në UNT do të jetë në dobi të sigurimit të ambienteve të domosdoshme për punë,

kompjuterë dhe internet për stafin dhe studentët.

- Investime të vazhdueshme dhe në kohë për mirëmbajtjen e sallave të leksioneve dhe seminareve.
- Konceptim, përgatitje dhe afishim i tabelave orientuese në hyrje të çdo godine (për të gjitha godinat e UNT së), ku të specifikohet numri dhe destinacioni (sallë leksionesh, seminar, laborator etj.), sipas kateve.

### **Integrimi i hulumtimit dhe ndërmarrësisë në UNT**

- Ndërmarrësia në universitet do të përbëjë një komponentë të rëndësishme të zhvillimit të universitetit;
- Fakultetet duhet të jenë entitete, ku do të gërshetohet hulumtimi dhe kapacitetet akademike e profesionale, me nevojat e kompanive;
- Do të përforcohet aktiviteti aktual i stafit për të ofruar konsulencë për biznesin si dhe trajnim për ndërmarrësi, për kompanitë e vogla dhe të mesme, si dhe për themelimin e kompanive të reja;
- Të gjitha kapacitetet që ka në disponim universiteti do të ofrohen për mbajtjen e seminareve dhe konferencave për partnerët e jashtëm, si dhe për organizimin e ngjarjeve që do të ndodhin në universitet.
- Do të përkrahët procesi i dizajnit të së paku një projekti të madh në çdo fakultet, që synon përkrahje të konsiderueshme financiare nga resurse të jashtme;
- Në këtë drejtim veprimi do të ishte a) *Përcaktimi qartë i prioriteteve bazë të kërkimit shkencor për çdo departament dhe fakultet.* b) *Gjykuar dhe mbështetur mbi këto prioritete, kërkimi shkencor në nivel universiteti, do të duhet që të ketë një vëmendje të veçantë dhe peshë të konsiderueshme.*

### **Përgatitje, aplikim dhe zhvillim projektsh**

Publikimi i aktivitetit shkencor të stafit tonë akademik e ka një vend të veçantë për zhvillimin e gjithmbarshëm të stafit akademik dhe universitetit cilësor në përgjithësi, prandaj UNT do mbështesë dhe do krijojë kushte vetanake për stimulimin e këtyre publikimeve në forma të ndryshme, si ato institucionale, po ashtu edhe ato vetanake.



## D) OBJEKTIVAT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË CILËSISË

Në kuadër të UNT është formuar zyra për sigurimin e cilësisë detyra e cilës është sigurimi i cilësisë dhe menaxhimi me cilësinë. Si rektor potencial i UNT do insistoj që në harmoni me rektoratin dhe zyrës për sigurimin e cilësisë të rritim mobilitetin e institucionit në përmesimin e cilësisë dhe rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit në mënyrë kontinuele përmes:

- Diskutimin për kualitetin në fakultete, kualitetin e programeve studimore dhe posacërisht kualitetin e procesit mësimorë;
- Diskutim për lidhjen e veprimtarisë mësimor- shkencore dhe veprimatrisë hulumtuese shkencore në fakultet dhe universitet.
- Ndjekjen dhe avansimin e kuadrit akademik mësimdhënës.
- Do të konsolidojmë dhe fuqizojmë zyrën për cilësinë e arsimit me komponentët tjera përkatëse duke përfshirë zhvillimin e kurrikulave, mbikëqyrjen, evaluimin, edukimin e përhershëm dhe trajnimeve .

Sfida e UNT në kushtet e konkurrencës agresive do të jetë menaxhimi me cilësinë. Deri tani në universitetet janë fokusuar kah kontrolli i cilësisë, megjithatë kjo është një e kaluar në trendet bashkohore. Sot kërkohet menaxhimi me cilësinë që parandalon gabimet, kërkohen dhe gjenden gabimet në procese, jepet ndihmesë dhe lehtësim, motivim etj.

Në kuadër të UNT do të rritet roli i ekipeve për sigurimin e cilësisë (ESC) – në nivel të çdo fakulteti ekzistojnë Ekipet e Sigurimit të Cilësisë (ESC), të cilat përbëhen nga anëtarët e fakultetit, administrata studentore, përfaqësuesit aktualë të studentëve dhe stekholderët e jashtëm nga lëmi (të) të konfirmuar nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit/qendrës. Ekipi e bënë implementimin e planit të sigurimit të cilësisë në kuadër të fakultetit.

Zyra për sigurimin e cilësisë ka për detyrë vetëevaluimin dhe do të jetë e drejtuar kah monitorimi dhe kah analiza e UNT në bazë të informacioneve dhe fakteve të cilat mund të jenë kualitative dhe kuantitative. Kjo zyrë me konstatimet dhe përfundimet lidhur me ate se çka është mirë dhe çka është keq në UNT dhe çka mundë të përmisohet dhe çka duhet të ndryshohet merr masa adekuate kah avansimi i performacës së UNT. Lidhur me sigurimin e cilësisë si metotë të planifikimit do ta përdorim SËOT analizën

si një metodë e vlerësimit e anëve të forta, anëve të dobta, mundësive dhe pengesave në zhvillimin e fakultetit.

Vlerësimi i cilësisë në kuadër të UNT përfshin gjithë spektrin e funksionimit të UNT dhe shërbimet e tij. Vlerësimet analizojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të UNT në të gjitha fushat e veprimit. Vlerësimi i masave të menaxhimit në të gjitha nivelet organizative në lidhje me :

- Vlerësimi i programeve të studimit dhe organizimit të studimeve..
- Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies.
- Vlerësimi i aktiviteteve kërkimore, hulumtuese dhe shkencore.
- Vlerësimet bëhen për t'i arritur objektivat, përshtatjen e punës dhe ekonomizimin e masave të marra.
- Vlerësimi i punës së mësimdhënësve dhe i kërkimeve shkencore.
- Vlerësimet e brendshme përmes vlerësimit vetanak.
- Pyetësorët dhe vetëvlerësimi nga ana e personelit akademik.
- Pyetësorët anonim të vlerësimit nga studentët.
- Analiza e parametrave në bazë të raportit të punës dhe përmbushjes së obligimeve.

### ***Përmisim të kushteve të studentëve***

Fuqizimi dhe konkretizimi i aktiviteteve për një partneritet të afërt dhe të përditshëm me studentët. Studentët janë arsyeja dhe qëllimi i punës tonë në universitet dhe prandaj do të jenë partnerë aktiv në të gjitha politikatat tona duke filluar nga organizimi i tyre ligjor dhe statusor që do të fillohet menjëherë. Po ashtu duke mbështetur dhe ndihmuar nevojat dhe aktivitetet e tyre që do të zhvillojnë në kuadër të strukturave të organizuara studentore.

Një rol të rëndësishëm mund të luajë vetëm mësimdhënia ku “studenti është në qendër apo fokus”. Zbatimi i të mësuarit dhe mësimdhënies me në qendër studentin mundëson respektimin e diversitetit ndaj studentëve dhe respektimin e nevojave të tyre duke mundësuar fleksibilitet më të madhe në rrugët e të mësuarit dhe kjo qasje do të na mundësojë që studentin të mos e shijojmë vetëm si përdorues i shërbimeve, por për t'i vënë në rolin e kompetentit dhe partnerët aktiv.

Standardi i studentëve është një sfidë e madhe për politikën arsimore të çdo vendi. Krahas komponentit social-ekonomik të studimit, ai mbulon edhe aktivizimin studentor, kulturën, sportin dhe angazhimin më të gjerë shoqëror. Në këtë drejtim UNT do të angazhohet në përmisimin e standardit të studentëve. Në këtë kuptim, universiteti ynë duhet në periudhën e ardhshme (përveç burimeve ekzistuese të bursave) për të gjetur fonde (nga burime të ndryshme) për bursa për studentë të kategorive të veçanta sociale, me theks të veçantë në studentë me aftësi të kufizuara dhe studentë nga kategoritë tjera.

Si një angazhim i veçantë strategjik i UNT do të jetë krijimi i një fondi të posaçëm për bursa për studentët e të ashtuquajturve të shkencave teknike, teknologjike, inzhnierike, shkencave natyrore, etj, Sigurisht që kjo duhet të mbështetet kryesisht nga Qeveria e RS të Maqedonisë së Veriut e cila tashmë është në proces të hartimit të Strategjisë për smart specializimeve.

Theks të veçantë në pjesën e studentëve do t'i jepte përfshirjes në rritje të studentëve në projektet kërkimore të realizuara në universitetin tonë. Në këtë mënyrë, përfitimet janë të shumëanshme. Nga njëra anë, kjo është mundësi për avancim të studentëve të interesuar për kërkime si dhe mundësia e tyre për të marrë njëfarë kompensimi financiar, natyrisht aty ku është e mundur dhe parashikohet nga legjislacioni ekzistues.

Nëse referohemi numrit të studentëve aktual sipas fakulteteve të regjistruara ku UNT ka gjithësesë 2030 student intenca kryesore do të jetë krijimi i kushteve për mësim për këtë numër të studentëve. Inetnca do të jenë që ky numër nga viti në vitë të rritet edhe më shumë. Shih tabelën.

**Tab.1** Numri aktual i studenteve

| Numri i studentëve aktiv në UNT |   |        |                 |     |     |     |
|---------------------------------|---|--------|-----------------|-----|-----|-----|
| Fakultetet e UNT                |   | Totali | Viti I studimit |     |     |     |
|                                 |   |        | I               | II  | III | IV  |
|                                 |   | 2 030  |                 |     |     |     |
| 1                               | Fakulteti I shkencave sociale               | 779    | 162             | 238 | 199 | 180 |
| 2                               | Fakulteti I shkencave teknologjike          | 199    |                 |     |     |     |
| 3                               | Fakulteti I shkencave teknike               | 676    | 218             | 193 | 153 | 112 |
| 4                               | Fakulteti I shkencave informatike           | 270    |                 |     |     |     |
| 5                               | Fakulteti i ndwrtimatrishw dhe arqitekturws | 106    | 34              | 29  | 30  | 12  |

### Studentë të regjistruar sipas mënyrës së studimit 2020/2021<sup>3</sup>

| Universiteti Nënë Terezë |   | Mënyra e studimit | Totali       | Gjinia     |            | Viti i studimit |            |            |            |
|--------------------------|---|-------------------|--------------|------------|------------|-----------------|------------|------------|------------|
|                          |   |                   | Totali       | femra      | meshkuj    | I               | II         | III        | IV         |
|                          |   | <b>Totali</b>     | <b>1 237</b> | <b>488</b> | <b>749</b> | <b>407</b>      | <b>303</b> | <b>330</b> | <b>197</b> |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | <b>1 159</b> | <b>468</b> | <b>691</b> | <b>385</b>      | <b>279</b> | <b>307</b> | <b>188</b> |
| 1                        | Fakulteti i shkencave shoqërore               | <b>Totali</b>     | 429          | 182        | 247        | 134             | 86         | 108        | 101        |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | 391          | 174        | 217        | 124             | 77         | 96         | 94         |
| 2                        | Fakulteti i shkencave Teknologjike            | <b>Totali</b>     | 104          | 76         | 28         | 25              | 31         | 36         | 12         |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | 103          | 75         | 28         | 25              | 30         | 36         | 12         |
| 3                        | Fakulteti i shkencave teknike                 | <b>Totali</b>     | 480          | 171        | 309        | 172             | 123        | 134        | 51         |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | 447          | 162        | 285        | 162             | 110        | 125        | 50         |
| 4                        | Fakulteti i shkencave informatike             | <b>Totali</b>     | 119          | 20         | 99         | 42              | 34         | 22         | 21         |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | 115          | 18         | 97         | 40              | 34         | 20         | 21         |
| 5                        | Fakulteti i ndërtimtarisë dhe infrastrukturës | <b>Totali</b>     | 105          | 39         | 66         | 34              | 29         | 30         | 12         |
|                          |   | <b>Të regullt</b> | 103          | 39         | 64         | 34              | 28         | 30         | 11         |

#### *Organizimi bibliotekës (online dhe fizike) për shfrytëzimin e literaturës*

Literatura botërore dhe e kohës më të re duhet të jetë në dispozicion të çdo studenti për një studim të mirëfilltë në kohën e sotme do të jetë synim pasurimi i bibliotekës së UNT që studentët të kenë literaturë më krahasueshmëri ndërkombëtare.

Do të themelohet edhe Qendra universitare e botimeve, ku studentët dhe të interesuarit të tjerë do të gjejnë literaturën dhe materialet tjera plotësuese për qëllime studimore dhe shkencore.

Do të iniciojm krijimin e degëve të bibliotekës në fakultete që përdoruesit e bibliotekës kanë qasje në librat e bibliotekës, online databazat, burimet elektronike dhe kompjuterët me qasje në internet, si dhe sallat e leximit, që i plotësojnë kërkesat dhe nevojat e çdo studenti.

<sup>3</sup> www. stat.gov.mk

## *Alumni Network*

Në UNT vitin e ardhshëm do të diplomojë gjenerata e parë. Duke marrë parasysh këtë moment të veçantë do të formojmë rrjetin e të diplomuarve të UNT-së. Ky rrjet do të zhvillohet me qëllim mbështetjen e rrjetit për universitetin, si dhe për formimin e një data baze që do të na ndihmojë të ndjekim suksesin e studentëve tanë.

Krijimi Qendrës së karrierës në UNT që do të jetë urë lidhëse në mes të studentëve të universitetit tone me kompanitë dhe institucionet në vend. Kjo qendër do të ishte në shërbim të studentëve dhe do të angazhohet të punoj me dy grupe të studentëve ato aktual dhe studentët e diplomuar në universitetin tonë. Studentëve të diplomuar u ndihmojmë në krijimin e karrierës së tyre duke u gjetur vende pune. Qendra e karrierës do të punoj që në bazë të rrjetit të konomukimit dhe bashkëpunimit me bizneset dhe industritë që studentëve aktual t'ju ndihmojë në procesin e kryerjes së mësimit praktik gjegjësisht, internship.

## E) TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI I STAFIT TË UNT

Në UNT kujdes të veçantë i kushtohet formimit dhe zhvillimit të stafit të mësidhënës dhe atij administrativ. Angazhimet e mia do të jenë që trajnimi (formimi dhe zhvillimi) i stafit bëhet në mënyrë permanente duke analizuar detyrat e tashme dhe detyrat ardheshme të universitetit dhe kompetenca e tashme kompetencat e ardheshme të kërkuara në harmoni me vizionin dhe misionin e UNT.

Numri aktual i stafit të UNT nuk është i mjaftueshëm duke ia referuar tabelës së më poshtme prandaj është i nevojshëm konsolidimi dhe fuqizimi i kapacitetit akademik (pedagogjik dhe shkencor me çka do të sigurohet numri i duhur i kuadrit, si dhe cilësia e tyre më e lartë) dhe administrativ (si në numrin e tyre poashtu edhe në teknologji) të UNT-së. Ky qëllim do të realizohet duke shtuar numrin e pedagogëve në përputhje me nevojat e programeve të reja studimore, respektivisht në përputhje edhe me Ligjin.

**Tab.2** Numri aktual i kuadrit mësimor sipas thirjeve mësimore shkencore<sup>4</sup>

| Universiteti Nënë Terezë                     | Profesor ordinar | Profesor inordinar | Docent | Asistent-Doktorant | Asistent | Bashkëpunëtor profesional |
|--|------------------|--------------------|--------|--------------------|----------|---------------------------|
| 1 Fakulteti i Shkencave të Informatikës      | 1                | 3                  | 4      | 1                  | 4        | 0                         |
| 2 Fakulteti i Shkencave Sociale              | 2                | 3                  | 12     | 4                  | 2        | 0                         |
| 3 Fakulteti i Shkencave Teknologjike         | 2                | 3                  | 5      | 4                  | 2        | 1                         |
| 4 Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës | 1                | 1                  | 7      | 2                  | 6        | 0                         |
| 5 Fakulteti i Shkencave Teknike              | 2                | 0                  | 9      | 6                  | 4        | 0                         |

<sup>4</sup> [www.unt.edu.mk](http://www.unt.edu.mk)

## F) OBJEKTIVAT NË FUSHËN E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT

### Objektivat në komunikim dhe bashkëpunim

- Orientimi kah bashkëpunimi ndër institucional i cili do përforcon lidhjet e institucioneve shkencore dhe arsimimore.
- Zgjerimi i komunikimit dhe i kontakteve direkte kombëtare dhe ndërkombëtare me fakultetet si motra, në fushën e organizimit të forumeve shkencore, konferencave dhe seminarve ku UNT do ta vërtetonte përmasën dhe profilizimin e vetë shkencor ekonomik.
- Bashkëpunimi tekniko-shkencor i mbrendëshëm dhe i jashtëm në shkëmbimin dhe qarkullimin e librave, revistave dhe publikacioneve që shfrytëzohen në hulumtimet fundamentale të shkencave ekonomike.
- Të ndërgjegjshëm për vleftën e rëndësishme të arsimimit dhe kualifikimit të kuadrit profesional do të nxisim bashkëpunimin më të gjitha universitetet e botës ku kanë studentët tanë të vazhdojnë specializimin.
- Bashkëpunimi ndërkombëtar është një nga komponentët bazike të zhvillimit drejt një universitet modern si një pjesë organike e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë. UNT do vazhdojë pasurimin e rrjetit bashkëpunues me universitetet si motra në vend, rajon dhe në Evropë por edhe më gjerë.
- Do të aplikojmë për më shumë aksione në COST, CEPUS, si dhe programe ku ka hapësirë edhe për arsimin e lartë si IPA programet, bashkëpunimi ndërkufitar etj. Për të lehtësuar këtë aktivitet do etablohet dhe fuqizohet Zyra e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Erasmus si dhe Zyra për Projekte si njësi e veçantë.

## G) OBJEKTIVAT NË BASHKËPUNIM MES UNIVERSITETEVE DHE KOMUNITETIT TË BIZNESIT

Universitetet gradualisht janë duke kaluar nga një fabrikë që prodhon dije në një universitet që krijon relacione sipërmarrëse aktive me bizneset dhe projekte hulumtuese të financuara nga sektori privat. Universitetet përgjithësisht janë të interesuar që dijen teorike dhe kërkimin teorik ta aplikojnë në praktikë ndërsa nga ana tjetër bizneset hulumtojnë dhe kërkojnë produkte dhe shërbime të reja përmes zbulimeve të ndryshme shkencore. Duke u bazuar në atë që theksuam më lartë do angazhohemi për një bashkëpunim në mes UNT dhe komunitetit të biznesit dhe industrisë

Fushat e bashkëpunimit midis UNT dhe ekonomisë dhe industrisë do të ishin:

**Transfer i njohurive** – ngërthen aktivitete interaktive të cilat përfshijnë ndërveprimet personale formale dhe jo formale, edukimin kooperativ, zhvillim të kurrikulave dhe shkëmbim personal

**Përkrahje në hulumtim** – përfshin kontributet financiare dhe në pajisje që bizneset ua bëjnë universiteteve për ngritje të laboratorëve, ofrim të bursave për studentë apo përkrahje të projekteve të ndryshme.

**Transfer i teknologjisë** – gjithashtu përfshin aktivitete interaktive. Këtu kemi të bëjmë me ndërveprimin e kërkimit universitar dhe ekspertizën e industrisë, e cila rezulton me kontribut në teknologji të komercializuar që kërkon tregu.



## H) FINANCIMI I UNT


**F**inancimi i qëndrueshëm është qenësor për funksionimin normal të një universiteti. Në aspektin financiar, UNT ekziston falë buxhetit të ndarë nga shteti, që ka shënuar rritje të vazhdueshme të buxhetit dhe një pjesë nga mjetet vetanake që gjithashtu kanë shënuar rritje.

**Tab.3** Buxheti i Universiteti Nënë Terezë<sup>5</sup>

| Vitet | Buxheti total denarë | Në euro   | Me rebalanc në denarë | Në euro   | Zvogëlimi i mjeteve në euro |
|-------|----------------------|-----------|-----------------------|-----------|-----------------------------|
| 2017  | 116,870,000          | 1,900,325 | 86,778,000            | 1,411,024 | 489,300                     |
| 2018  | 308,388,000          | 5,014,439 | 192,400,000           | 3,128,455 | 1,885,984                   |
| 2019  | 328,784,000          | 5,346,081 | 171,165,000           | 2,783,171 | 2,562,911                   |
| 2021  | 207,635,000          | 3,376,179 | 194,240,000           | 3,158,374 | 217,805                     |
| 2022  | 310,155,000          | 5,043,171 |                       | 0         |                             |


Burimet shtese të cilat me rebalancin janë zvogëluar kanë të bëjnë lidhur me ndërtimin e infrastrukturës. Kështu që nga tabela mundet të shihet se UNT vite pas viti i janë zvogëluar mjete financiare nga buxheti.

**Grafik.1** Buxheti i Universiteti Nënë Terezë 2017-2022



<sup>5</sup> www. finance.gov.mk. Buxheti i RMV, 2017-2022

**Grafik.2** Buxhet rebalanci i UNT sipas viteve (2017-2022)



Buxheti i planifikuar i Universitetit Nënë Terezë për vitin 2022 është si vijon: planifikimi i dalave të përgjithëshme është 310.155.000 denar, ku të dalat nga buxheti themorë është 235.500.000 denar, të dalat nga vetë financimi janë 51.755,000 denar dhe të dalat nga donacionet janë 4.900.000 denar. Në mënyrë tabelare planifikimi i të dalave është paraqitur në tabelë.


**Tab.4** Buxheti iplanifikuar Universiteti Nënë Terezë<sup>6</sup> për vitin 2022

| Universiteti Nënë Tereza              | Të dalat nga buxheti themelor | Të dalat nga buxheti themelor në euro | Të dalat nga aktivitetet vetëfinancuese | Të dalat nga aktivitetet vetëfinancuese në euro | Të dalat nga donacionet | Të dalat nga donacionet në euro | Totali i dalave    | Në euro          |
|---------------------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|---|---|-------------------------|---------------------------------|--------------------|------------------|
| <b>Të dalat e përgjithshme</b>        | <b>253,500,000</b>            | <b>4,121,951</b>                      | <b>51,755,000</b>                       | <b>841,545</b>                                  | <b>4,900,000</b>        | <b>79,675</b>                   | <b>310,155,000</b> | <b>5,043,171</b> |
| Të ardhurat personale dhe kontributet | 88,500,000                    | 1,439,024                             | 24,255,000                              | 394,390   | 0                       | 0                               | 112,755,000        | 1,833,415        |
| Të ardhurat neto                      | 63,450,000                    | 1,031,707                             | 17,464,000                              | 283,967   |                         | 0                               | 80,914,000         | 1,315,675        |
| Kontributet per sigurim social        | 25,050,000                    | 407,317                               | 6,791,000                               | 142,943   |                         | 0                               | 31,841,000         | 517,739          |
| Mallrat dhe shërbimet                 | 24,800,000                    | 403,252                               | 20,000,000                              | 325,203   | 3,900,000               | 63,415                          | 48,700,000         | 791,870          |
| Shpezimet ditore dhe te udhëtimit     | 100,000                       | 1,626                                 | 1,500,000                               | 24,390  | 200,000                 | 3,252                           | 1,800,000          | 29,268           |
| Shërbime komunale, nxemja             | 3,500,000                     | 56,911                                | 2,500,000                               | 40,650  | 500,000                 | 8,130                           | 6,500,000          | 105,691          |
| Materialet dhe inventari i imët       | 700,000                       | 11,382                                | 2,000,000                               | 32,520  | 100,000                 | 1,626                           | 2,800,000          | 45,528           |
| Riparimet dhe mirembajtja rrjedhëse   | 500,000                       | 8,130                                 | 1,000,000                               | 16,260  |                         | 0                               | 1,500,000          | 24,390           |
| Shërbimet kontraktuale                | 20,000,000                    | 325,203                               | 10,500,000                              | 170,732   | 3,000,000               | 48,780                          | 33,500,000         | 544,715          |
| Shpenzimet tjera rrjedhëse            | 0                             | 0                                     | 2,500,000                               | 40,650  | 100,000                 | 1,626                           | 2,600,000          | 42,276           |
| Subvencionet dhe transferet           | 200,000                       | 3,252                                 | 1,500,000                               | 24,390  |                         | 0                               | 1,700,000          | 27,642           |
| Tresferet e ndryshme                  | 200,000                       | 3,252                                 | 1,500,000                               | 24,390  |                         | 0                               | 1,700,000          | 27,642           |
| Shpenzimet kapitale                   | 140,000,000                   | 2,276,423                             | 6,000,000                               | 97,561  | 1,000,000               | 16,260                          | 147,000,000        | 2,390,244        |
| Blerje e mjeteve dhe makinave         | 15,000,000                    | 243,902                               | 2,500,000                               | 40,650  | 1,000,000               | 16,260                          | 18,500,000         | 300,813          |
| Objektet tjera ndertimore             | 120,000,000                   | 1,951,220                             | 2,500,000                               | 40,650  | 0                       | 0                               | 122,500,000        | 1,991,870        |
| Investimi në mjete jofinanciarde      | 5,000,000                     | 81,301                                | 1,000,000                               | 16,260  |                         | 0                               | 6,000,000          | 97,561           |

<sup>6</sup> www. finance.gov.mk. Buxheti i RVM

Po të analizohen planifikimi i dalave të UNT sipas burimeve të financimit do të ishte si vijon. 4.121.951 euro të dalat nga buxheti themelor, 841.545 euro nga mjetet vetanake dhe 79.675 euro të dalat nga donacionet.

**Grafik.2** UNT-Planifikimi i të dalave 2022 sipas burimeve në euro




Politikat e vjetëruara të financimit të arsimit të lartë duhet ndryshuar MASH-i i zbaton pjesërisht kriteret e miratuara në Marrëveshjen e Vetëqeverisjes të vitit 1988, Para për paga dhe kontribute, shpenzimet materiale (për energji elektrike, ujë, për PTT, për higjienë dhe furnizime zyre), mjetet për ngrohje; fondet për shpenzimet kapitale (pajisje dhe investime) që janë miratuar sipas kërkesave të universiteteve. Si rektor do të jem shumë i interesuar të ndryshohet ky model i financimit të universiteteve në vend. Do të iniciojm debate dhe iniciativa që të miratohet një model të ri financimi për të cilin është e nevojshme të miratojë një strategji për financimin e arsimit të lartë në përputhje me analizat dhe nevojat e shtetit për financim dhe sigurim të cilësisë në arsimin e lartë. Të miratohen kriteret e qarta për financimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë; të sigurohet autonomi më e madhe e universiteve në menaxhimin financiar; përveç kriterëve të hyrjes apo inputeve, duhet të përdoret edhe kriteri i outputit për financimin e institucioneve të arsimit të lartë; formula për financim i përfshinë kriteriumet hyrëse dhe dalëse: studentët e regjistruar, të diplomuar, punësimi, hulumtimet, studentët e doktoratës, publikimet citimet etj.

Do të anagzohem që pagat e mësidhënsve në UNT të jenë me krahasueshmëri me universitetet tejsra që kanë paga më ta larta se UNT. Për këtë qëllim të do ngrëjm një grup pune që do të gjejë modalitete se si kjo do të realizohet në harmoni me dipozitat në fuqi.

Në vijim është paraqitur struktura aktuale e financimit të pagave në UNT që mendoj se duhet të rrishikohet.

Po të analiyohen të adhurat e punonjësve të UNT 1.439.024 euro finacoohen nga buxheti themelor dhe 349.390 euro nga mjetet vetanake apo vetëfinacuese.

**Grafiku 3.** UNT- Të ardhurat personale dhe kontributet në euro



Sigurimi i të hyrave vetanake është aspekt me rëndësi i funksionimit të një universiteti , këto mjete aktualisht të ulëta si nga burimet vetanake, si nga donacionet është shumë e rëndësishme të shfrytëzohen një shumëllojshmëri burimesh financiare, që sigurojnë stabilitet dhe standard më të lartë. Burimet shtesë të fituara do të mund të përdoren për rritjen e të ardhurave të stafit të dalluar, përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë informative, rritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe mirëmbajtjen e tyre.

Është shumë rëndësi rritja e të hyrave buxhetore dhe efikasitetit në menaxhimin e buxhetit angazhimet në këtë drejtim do të ishin:

- Të krijohet një grup këshillëdhënës për ngritjen e fondeve dhe zhvillim të UNT-së, i përbërë nga


anëtarë jashtë universitetit, të cilët përfaqësojnë bizneset kulminante vendore e ndërkombëtare;

- Të rritet buxheti dhe shumëllojshmëria e financimit (financimi nga donatorët e jashtëm, kontributi i ish-studentëve të UNT, dhuratat/ ndihmat private dhe nga kompanitë, pagesat e shkollimit , projektet kërkimore, shërbimet konsulente);

### Investimet kapitale në UNT

Sigurimi i kushteve infrastrukturore (ambientale dhe tekniko-teknologjike) për mbarëvajtjen e studimeve dhe punës kërkimore -shkencore është shumë i rëndësishëm në UNT. Ky qëllim do të realizohet duke vazhduar me përgaditjen e hapësirave plotësuese për studim dhe duke adaptuar edhe ato ekzistuese për mësimdhënie pa pengesa. Përgaditja dhe pajisja plotësuese e laboratorëve në vendet ku ato tani po funksionojnë. Mobilimi dhe përgaditja tekniko informatike në shkallën më të lartë të mundshme me hardëare dhe softëare adekuate për mësim modern të avansuar. Duke u bazuar në hapësirat dhe objektet që I ka në dispozicion UNT do të bëjm angazhime në dinamike që të adaptohen objektet ekzistuese për të krijuar kushte për mësim dhe hulumtim. Për këtë qëllim do të shfrytëzohen me tet buxhetore posaqërishtë investimet kapitale që siças buchetit I ka në dispozicion UNT e që janë 2.390.244 euro.

**Grafiku 4.** Planifikimi i investimet kapiatele në UNT 2022 në euro



## I) OBJEKTIVAT PËR PROMOVIMIN E UNT-së

**M**enaxhmenti i UNT do të rris promovimin e UNT si në nivelin kombëtarë dhe atë ndërkombëtar. Në këtë drejtim do nënvizoja:

- Rritje e numrit të studentëve të regjistruar në studimet deridiplomike.
- Vizitë e shkollave të mesme publike dhe private.
- Zhvillim i ligjëratave orientuese më nxënësit.
- Zhvillim i ANKETAVE së studentëve aktual për të parë mundësitë e kyçjes së tyre në tërheqjen e studentëve të rinj nga radhët e miqve dhe familjarëve të tyre, dhe krijimi i bazës së të dhënave në bazë të hulumtimit në fjalë.
- Shfrytëzim i rrjeteve sociale për të komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me studentët potencial.
- Organizim i takimeve me prindërit e nxënësve në bazë të data bazës së formuar nga anketa.
- Krijim i një broshure të përpiluar enkas për prindërit e nxënësve të viteve të katërta të shkollave të mesme dhe studentëve aktual të studimeve deridiplomike në UNT mbi mundësitë që ofron kurikula e fakultetit, në titull “INVEST IN YOUR CHILDREN, INVEST IN YOUR FAMILY”.
- Krijim i data bazës së studentëve të suksesshëm në kompani të dalluara botërore.
- Rritje e studentëve në fjalë, që të participojnë në promovimin e fakultetit.
- Deri tani kemi pasur disa aktivitete që të tërheqim studentë të rinj. Këto aktivitete do të vazhdojnë dhe do përfshijnë vizita nëpër shkollat e mesme, si dhe “Open Day” apo një ditë kur universiteti ynë është i hapur për të gjithë.

Prof. Dr. Izet Zeqiri

